

BASHKIA MALËSI E MADHE
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

Bashkia Malësi e Madhe kërkon të japë me qira sipërfaqe të fondit pyjor kullosor për qëllime pushimi, argëtimi dhe për veprimtari turistike, kampingje etj.

1. Fillimi i procedurave për dhënie me qira me anë të konkurimit të sipërfaqes së fondit Pyjor /kullosor publik sipas udhëzimit nr.1, date 09.06.2016 “ Për rregullat , Procedurat e Kërkimit , të shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për Dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik” ndodhet ne zonën kadastrale 3834 Nr.pasurie 869 të ekonomisë pyjore Fushë Zezë , me sipërfaqe 0.7844 ha dhe shtrihet në ngastren/nëngastren 107.

2. Cmimi dysHEME për fillimin e konkurimit do të jetë 96 184 (nëntëdhjetëegjashtënjëqindetëdhjetëekatërmijë) lekë/ha/vit mbështetur në Raportin Teknik dhe tarifave të përcaktuara në, VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” shtojca1/10 .

3. Afati i dhënies me qira do të jetë 10 vjet.

4. Veprimtaria që do të ushtrohet në sipërfaqen që do të jepet me qira , bazuar në Raportin Teknik nr.1298/2 Prot, datë 21.06.2024 do të jetë “ Për qëllime pushimi, argëtimi dhe për veprimtari turistike,kampingje etj.

5. Personat fizikë dhe juridike që do të marrin pjesë në konkurrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- a) kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetin e tyre ;
- b) ekstratin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- c) projektin teknik të hartuar nga specialistë të hartuar nga specialistë të licensuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- d) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen ;
- e) të dhëna për kapacitet teknike ,stafin ,makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- f) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme ;
- g) nivelin e punësimit në veprimtari;
- h) leje mjedisore për ushtrimin e aktivitetit të kërkuar / raport paraprak i vlerësimit të ndikimit ne mjedis hartuar nga specialiste të licensuar;
- i) cmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- j) adresën e subjektit ,telefon , email dhe faks.

6. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim ,janë:

- a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes (për këtë të paraqesë sigurimin e ofertës në masen 2% të vlerës së investimit të parashikuar);
- b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës , ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushen e veprimtarisë ;
- c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim , hetim në proces , detyime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.

7. Vlerësimi i ofertës mbështetet në grumbullimin e pikëve si më poshte:

- a) projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet , i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore , si :kufijtë natyrore , relievi ,objektet aktuale , si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar , hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë ;
- b) planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë ;
- c) planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë;
- d) nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë ;
- e) masën e qirasë për ha/vit 35 pikë.

Dokumentacioni i konkurimit duhet të paraqitet në një zarf të mbyllur të nënshkruar nga konkuresi me mbishkrimin “ Ofertë për dhënien me qira” dhe i dorëzohet komisionit të vlerësimit të ofertave në orën dhe datën e hapjes së konkurimit .

Mosparaqitja e njërit prej dokumentave të mësipërme përbën shkak për skualifikim .

Vendi i zhvillimit të konkurimit : Bashkia Malësi e Madhe, Koplík Qendër, Malësi e Madhe.

Ofertat dorëzohen nga të interesuarit/ konkurentët , fizikisht , me postë ose dorazi pranë sekretarisë së Bashkisë Malësi e Madhe.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave të interesuarve / konkurrentëve është data 18.07.2024 ora 12:00.

Afati për hapjen e ofertave të konkurrentëve do të jetë data 18.07.2024 ora 12:00, Godina e Bashkisë Malësi e Madhe.